

**NJOFTIM  
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME  
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. \_\_\_\_\_ (Aksioner/Përfaqesues/e i/eAksionerit \_\_\_\_\_)

Ju njoftojmë se ditën e enjte datë 9 Tetor 2025 ora 11:00 në ambientet e " BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për rritjen e kapitalit të Bankës Credins në masën 27 milion Euro nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja.
2. Propozim për rritjen e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv. Drejtores së Përgjithshme sipas rritjes së miratuar në Buxhetin e "Bankës Credins" sha për vitin 2025.
3. Mbi dhënien e miratimit për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitorëve të Bankës Credins si rezultat i procesit përmbarimor.
  - Miratimi i veprimeve të organeve dhe/ose strukturave që kanë vepruar në emër dhe për llogari të Bankës Credins për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitorëve të Bankës Credins si rezultat i procesit përmbarimor.
  - Autorizohet Drejtoria të ndjekë të gjitha hapat ligjore dhe të nënshkruajë çdo akt, kërkesë, aplikim, kontratë, etj., deri në kompletimin e procesit të marrjes në pronësi të pasurive.
4. Mbi dhënien e miratimit të blerjes së plotë të paketës së aksioneve të zotëruara nga ana e aksionarëve të tjerë pranë Bankës Credins Kosovë sh.a, sipas pasqyrit të tyre në regjistrin e aksioneve pranë Bankës Credins Kosovë sh.a, me çmimin e blerjes së këtyre aksioneve.
5. Mbi dhënien e tagrave për ekzekutimin e këtij projekti dhe procedurave përkatëse si në vijim:
  - a. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Credins sh.a, Z. Maltin Korkuti të negociojë çdo aspekt, afatet dhe kushtet e përgjithshme dhe specifike apo ato të rastit, të përcaktojë dhe nënshkruajë në të gjitha fazat e zhvillimit të negociatave dhe nënshkrimit të akteve përfundimtare, qofshin këto veprime paraprake apo finale, akte të njëanshme apo të dyanshme, noteriale ose jo, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, çdo lloj akti dhe veprimi juridik për të bërë të mundur finalizimin e blerjes së aksioneve të aksionarëve të Banka Credins Kosovë sh.a;
  - b. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Credins sh.a, Z. Maltin Korkuti të bëjë të gjitha deklaratimet dhe aplikimet e nevojshme për kompletimin e këtij projekti, të përfaqësojë Bankën Credins sh.a në çdo situatë dhe përballë çdo institucioni publik apo privat, si dhe të ndërmarrë çdo lloj iniciative ligjore dhe proceduriale për të respektuar kërkesat e ligjit të aplikueshme dhe kryerjen e të gjitha veprimeve për shlyerjen e çmimit të blerjes dhe/ose çdo lloj detyrimi tjetër, sipas ligjit.

- c. Autorizohet Drejtori i Përgjithshem i Bankës Credins sh.a, Z. Maltin Korkuti që të veprojë vetëm ose nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar me autorizim apo prokurë nga ana e tij për çdo aspekt të këtij projekti dhe marrëdhënieve që zhvillohen për këtë shkak, për nogociatat, nënshkrimet dhe çdo veprim tjetër, duke ruajtur dhe vepruar në interesin më të mirë të Bankës Credins sh.a.
6. Mbi dhënien e miratimit për financimin sipas kushteve paraprake të ofruara nga Black Sea Trade and Development Bank (BSTDB);
7. Mbi dhënien e miratimit dhe autorizimit të plotë të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Maltin Korkuti, për të kryer të gjitha veprimet dhe nënshkrimet përkatëse në kuadër të projektit për financimin nga Black Sea Trade and Development Bank ("BSTDB"):
  - a. Autorizohet Drejtori i Përgjithshem i Banka Credins sh.a, Z. Maltin Korkuti ose çdo person tjetër i autorizuar prej këtij të fundit, për të kryer të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm në emër të shoqërisë Banka Credins sh.a, duke përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti, marrëveshje ose akordi që lidhet me financimin nga Black Sea Trade and Development Bank, bashkëpunimin ose veprime të tjera të lidhura me projektin/financimin në fjalë.
  - b. Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen në negociatat, përgatitjen dhe nënshkrimin e dokumenteve të nevojshme, administrimin, marrëdhënien dhe marrjen e vendimeve të nevojshme dhe çdo hap tjetër të domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të këtij autorizimi.
  - c. Ky autorizim është i vlefshëm deri në përfundim të projektit dhe marrjes eventuale të financimit.
8. Mbi dhënien e miratimit për vendim-marrjen e Bankës Credins Shqipëri në mbledhjet e Asamblesë së "Banka Credins Kosovë" të zhvilluara deri më sot dhe caktimi i autoritetit dhe kompetencave për përfaqësimin e Bankës Credins Shqipëri në të ardhmen, në lidhje me të gjitha kompetencat që Statuti i Bankës Credins Kosovë ja rezervon Asamblesë së Aksionarëve.
9. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

**Maltin KORKUTI**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Tiranë me 15.09.2025

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.